



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:107616  
Datë: 29.02.2024  
Numri i dokumentit: 05392384

C.nr.1683/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.M. nga Prizreni me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.A. nga Prizreni, kundër të paditurit D.K. me vendbanim në rr. “ .....” në Prizren, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 29.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.1683/2023 e datës 12.05.2023, parashtruar nga paditësi S.M. nga Prizreni, kundër të paditurit D.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi S.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, av. A.A. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me dt.12.05.2023 ka parashtruar padi, kundër të paditurit D.K. nga Prizreni, me objekt të kontestit vërtetim pronësie.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, gjykata me dt. 27.02.2023 nga përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, av. Alija Ajro, ka pranuar parashtresën e datës 27.02.2024, përmes së cilës ka njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë dhe kërkesëpadinë në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që palët ndërgjyqëse këtë çështje e kanë zgjidhur në mënyrë alternative andaj edhe më nuk kanë interes që e njejta vazhdohet pranë kësaj gjykate.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të konstatohet e tërhequr padia e paditësit. Kështu, në nenin 261 par. 1 të LPK-së theksohet që “*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*”. Pastaj, me nenin 261 par. 3 të LPK-së përcaktohet se “*po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia*”. Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që padia e paditësit të konstatohet e tërhequr në përputhje me nenin 261 par. 1 të LPK-së lidhur me nenin 263 par. 3 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 261 dhe 387 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.1683/2023, datë 29.02.2024

Gj y q t a r j a

---

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të nenit 261 par. 4 të LPK-së.